

VENDIM
Nr. 315, datë 15.4.2015

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:
 - a) Në pikën 1/2 shtohet emërtesa “Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale”.
 - b) Në shkronjën “b”, të pikës 1/3, shtohet emërtesa “Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2015.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrín efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama